



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government

*Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i
Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology*
Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë

Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë, Këshilli Shkencor i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore dt. 28 mars 2013 (Gazeta zyrtare nr. 11/02 maj 2013) dhe Udhëzimit administrativ nr. 01/2017, dt. 30.01.2017 për mbështetjen financiare për aplikim të fondeve nga MASHT për botime dhe publikime shkencore në revista me faktorë ndikimi, shpall:

KONKURS

(Për financimin e botimeve dhe publikimeve shkencore në revista me faktorë ndikimi për vitin 2018)

-MASHT/ DSHT mbulon shpenzimet e publikimeve për revista shkencore të indeksuara në Web of Science dhe Scoopus me faktorë ndikimi pozitiv të autorëve të cilët punën e tyre kërkimore e realizojnë në institucionet kërkimore-shkencore të Kosovës.

-Financohen botime/publikime nga fushat prioritare shkencore të parapara në Programin Kombëtar të Shkencës:

Fushat shkencore prioritare për aplikim:

1. Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi;
2. Prodhimi bujqësor.
3. Studimet mjekësore.
4. Studimet ekonomike dhe sociale.
5. Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike.
6. Hulumtime ndërdisiplinare për teknologjitë e komunikimit dhe informacionit.

Kush mund të aplikojë ?

- Aplikimet për botime/ publikime të veçanta bëhen vetëm prej personit fizik.
- Merren parasysh botimet/publikimet e individëve dhe institucioneve që e ushtrojnë veprimtarinë shkencore në Republikën e Kosovës.
- Aplikimi bëhet vetëm prej autorit.

Për aplikim për botim duhet të plotësohen këto dokumente:

- **Letërnjoftimi i aplikuesit (kopja)**
- **Aplikacioni i plotësuar**
- **Autori duhet të dëshmoj me shkrim se punimi i tij / saj, është i publikuar në Web of Science dhe Scopus.**
- **Deklaratë e noterizuar nga autori që punimi nuk është i botuar pjesërisht apo tërësisht më herët dhe që nuk ka sponsorë të tjerë.**
- **Autori duhet ta dëshmoj transaksionin e pagesës.**
- **Financohen vetëm dy punime të një autori të publikuara në revista që janë të indeksuara dhe të listuara në platformën Scopus dhe Web of Science brenda një viti.**
- **Mbulohen deri në 80% e shpenzimeve të publikimit.**
- **Kërkesat tjera në bazë të UA për botime dhe publikime.**

Konkursi mbetet i hapur nga **19.02.2018** deri më **30.10. 2018** .

- Aplikacioni me dokumentacion të kompletuar dorëzohet në arkivin e MASHT-it, zyra nr.4, ndërsa të gjitha informatat rreth aplikimit merren në zyrën nr. 302/b te z. Fidan Kozhani

Dokumentacionet e pakompletuara dhe aplikimi me vonesë nuk shqyrtohen

Detajet e kontaktit;

Emri: Fidan Kozhani

Posta elektronike :

e-mail: fidan.kozhani@rks-gov.net, adresa postare :

Rr. “Agim Ramadani” p.n 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.+381(0) 38 200 20123